



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

MIRATOI

SENATI AKADEMIK I UBT

KRYETARI

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË DOKTORATËS NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS (UBT)

Tiranë 2025

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i Rregullores

1. Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave të detajuara për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të programit të studimeve të doktoratës në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me Statutin e UBT-së dhe me Kodin e Etikës së tij.
2. Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe rregullat që zbatohen nga subjektet pjesëmarrëse në programin e doktoratës, për të mundësuar përfitimin e gradës shkencore “Doktor” në UBT, të drejtat dhe detyrimet e studentëve të regjistruar, si dhe të njësive dhe strukturave përgjegjëse për ndjekjen dhe monitorimin e këtij procesi, duke përfshirë edhe raportet me organet dhe autoritetet përgjegjëse për mbarëvajtjen e programit të doktoratës në UBT.

Neni 2

Objektivat dhe fusha e veprimit të Rregullores

Programi i studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë” në UBT ka si objektiva:

1. Kualifikimin dhe edukimin e kërkuesve shkencorë në një nivel të lartë kërkimor, në përputhje me parimet e njohura shkencore dhe etike të UBT-së, të sanksionuara nga Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor...” dhe nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar;
2. Nxitjen e kërkimit shkencor në një fushë të caktuar, duke u orientuar drejt krijimit, thellimit, rikonceptimit dhe integritetit të njohurive dhe rezultateve të kërkimit, me qëllim sjelljen e risive në mendimin shkencor;
3. Realizimin nga doktorantët të projektit të tyre të kërkimit shkencor dhe mbrojtjen e tij para jurisë, për përfitimin e gradës shkencore “Doktor”.

Fusha e veprimit e kësaj Rregulloreje përfshin programin e ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”, në të gjitha njësitë kryesore të UBT-së, nga aplikimi deri në përfundimin e programit kërkimor dhe dhënien e gradës shkencore.

Neni 3 Baza ligjore

Rregullorja mbi organizimin e studimeve të ciklit të tretë, për përfitimin e gradës shkencore “Doktor” në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), bazohet në dispozitat e mëposhtme ligjore dhe nënligjore:

1. Ligji nr. 80/2015, *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*;
2. Ligji nr. 109/2024, *“Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”*;
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, *“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”*, i ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 879, datë 18.12.2019;
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, *“Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’”*, i ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 11.12.2019, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 128, datë 06.03.2024.
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 26.12.2018, *“Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”*, i ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 05.02.2020;
6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018, *“Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”*;
7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, *“Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”*;
8. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 52, datë 03.12.2015, *“Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”*, i ndryshuar;
9. Udhëzimi nr. 29, datë 10.09.2018, *“Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”*, i ndryshuar;
10. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 16, datë 08.07.2019, *“Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”*;
11. Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.09.2019, *“Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”*;
12. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 29, datë 18.12.2019, *“Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërore të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar me udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 3, datë 21.01.2025
13. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 1, datë 14.01.2020, *“Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit”*, i ndryshuar me udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 7, datë 31.03.2021;
14. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 10, datë 30.03.2020, *“Për përcaktimin e elementeve përbërëse, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuara nga institucionet e*

arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” i ndryshuar me udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 5, datë 21.01.2025;

15. Urdhrat e Ministrit të Arsimit dhe Sportit për riorganizimin e programeve të ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin Bujqësor të Tiranës;
16. Standardet për akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të tretë;
17. Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës;
18. Rregullorja e Universitetit Bujqësor të Tiranës;
19. Kodi i Etikës së UBT-së;
20. Rregullorja për sjelljen me integritet në kërkimin shkencor dhe promovimin akademik.

Neni 4

Të përgjithshme

1. Programet e studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë”, të mbështetura në pikën 1 të nenit 77 të Ligjit nr. 80/2015, *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, përfaqësojnë ciklin e tretë të formimit universitar, me karakter plotësisht akademik, të bazuar në kërkimin shkencor për përgatitjen e disertacionit, rezultatet dhe mbrojtja e suksesshme e të cilit çojnë në përfitimin e gradës shkencore “Doktor”.
2. Studimet e doktoratës mbështeten në programe individuale për aftësimin e pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në përputhje me fushat e përcaktuara nga njësitë bazë dhe njësitë kryesore të UBT-së.
3. Studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë përkatëse. Në raste të veçanta, ato mund të zhvillohen me kohë të zgjatur, kur kandidati është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë ose si personel kërkimor në një institucion të kërkimit shkencor bazë ose të zbatuar, në përputhje me nenin 79, pika 2 të Ligjit nr. 80/2015 dhe kreun I, pika 1 të VKM nr. 112, datë 23.02.2018 *i ndryshuar*.
4. Programet e studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë” mbështeten në fushat e gjera të kërkimit, të përcaktuara nga njësitë bazë dhe kryesore dhe realizohen në koordinim me aktivitetet kërkimore të grupeve përkatëse kërkimore brenda njësisë bazë.
5. Programet e studimeve “Doktoratë” mund të jenë ndërdisiplinore ose të përbashkëta, në nivelin e njësive bazë, të njësive kryesore të UBT-së, si dhe në bashkëpunim me institucione të tjera kërkimore vendase ose të huaja, mbi bazën e marrëveshjeve të veçanta.

Neni 5

Përmbajtja e programit

1. Programi i studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë” organizohet në mënyrë që të garantojë:
 - a. Mundësi për kërkim shkencor të pavarur nga ana e doktorantit, në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor dhe me kërkues të tjerë.
 - b. Pjesëmarrje aktive në grupe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
 - c. Përpilimin e disertacionit, të bazuar në punën kërkimore-shkencore të kryer gjatë programit të studimeve.
2. Programi i doktoratës duhet të pasqyrojë në mënyrë të detajuar:
 - a. Planin e aktiviteteve kërkimore të studentëve të doktoratës dhe mënyrën e monitorimit të ecurisë së tyre (afatet kohore, numri i raportimeve në njësinë bazë, botimet shkencore, pjesëmarrja në konferenca, etj.).
 - b. Planin e angazhimit të studentëve të doktoratës në aktivitete ndihmëse të procesit akademik në grupet mësimore dhe njësitë bazë përkatëse (mbështetja për studentët, udhëheqja e temave të diplomës, praktikat mësimore dhe profesionale, etj.).

Neni 6

Organet dhe autoritetet përgjegjëse

Organet dhe autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin Bujqësor të Tiranës janë:

1. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, në nivel njësie kryesore.
2. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”.
3. Drejtuesi i njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin/programet e studimeve të doktoratës.
4. Koordinator i programit të studimeve të doktoratës.

Neni 7

Hapja e programeve të studimeve të ciklit të tretë

1. Njësia kryesore, pas konsultimeve me njësitë bazë, bën propozimin zyrtar për hapjen ose riorganizimin e programeve të doktoratës, nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë:

- a. Përmbushjen e kërkesave të personelit akademik me titull “Profesor i Asociuar” ose “Profesor”.
- b. Disponimin e numrit të nevojshëm të personelit akademik të kualifikuar për të udhëhequr secilin student të doktoratës, si në veprimtarinë kërkimore, ashtu edhe në detyrat përkatëse didaktike, në përputhje me kuotat e kërkuara.
- c. Sigurimin e strukturave të posaçme operative dhe kërkimore, në funksion të aktiviteteve të parashikuara në programin e studimit të doktoratës (laboratorë, biblioteka, abonime shkencore, qendra kërkimore, etj.), si dhe të infrastrukturës së nevojshme mbështetëse.
- d. Sigurimin e burimeve financiare të mjaftueshme për vazhdimësinë dhe për realizimin e të gjitha fazave të procesit të kërkimit të doktoratës.
- e. Përcaktimin e mënyrave të raportimit periodik pranë njësisë bazë, në përputhje me planin trevjeçar të zhvillimit të programit dhe me progres-raportet vjetore për verifikimin e veprimtarisë kërkimore të studentëve të ciklit të tretë.

Neni 8

Procedura për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës

1. Njësia kryesore i paraqet fillimisht Rektoratit të UBT-së, dhe më pas Senatit Akademik të UBT-së, propozimin për hapjen e një programi të ri të studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë”, ose për riorganizimin e një programi ekzistues. Propozimi duhet të jetë i formuluar në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
2. Propozimi duhet të përmbajë, ndër të tjera:
 - a. Dokumentin në të cilin përcaktohen fusha shkencore dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të tretë, të shoqëruar me relacionin shpjegues nga njësia kryesore mbi rëndësinë dhe nevojën për zhvillimin e kësaj fushe. Programi duhet të përgatitet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Statutin e UBT-së;
 - b. Të dhëna mbi organizimin akademik të programit;
 - c. Të dhëna mbi planin zhvillimor të programit të doktoratës;
 - d. Të dhëna mbi koordinatorin e programit;
 - e. Afatet kohore të realizimit të programit të studimit;
 - f. Burimet financiare për realizimin e programit, duke përfshirë mundësinë e vetëfinansimit, grantet për projekte kërkimore, apo forma të tjera mbështetjeje;
 - g. Kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues, të cilat përcaktohen nga njësia bazë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, duke respektuar parimin e vijimësisë në fushë të njëjtë ose të përafërt me studimet e ciklit të parë dhe të dytë;
 - h. Tarifat e studimeve për çdo student (të argumentuara), si dhe burimet e tjera të mundshme të financimit për programin, në përputhje me specifikat dhe propozimet e njësisë kryesore;

- i. Personelin akademik të angazhuar në udhëheqjen e doktorantëve, duke përfshirë titullin ose gradën shkencore, numrin maksimal të studentëve për udhëheqës, si dhe të dhëna mbi personelin e ftuar, i cili duhet të miratohet paraprakisht nga drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse;
 - j. Të dhëna mbi strukturën organizative dhe drejtimin administrativ të programit, përfshirë rastet kur programi është ndërdisiplinor, ndërdepartamentor apo ndërinstitutional;
 - k. Marrëveshje ndërinstitutionale të UBT-së, të paktën me një universitet të një vendi anëtar të OECD-së, që garantojnë shkëmbime të personelit akademik dhe të studentëve të doktoratës, si dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore;
 - l. Emërtimin e njësisë ose njësive bazë propozuese të programit, të cilat garantojnë ekzistencën e infrastrukturës ndërtimore, laboratorike dhe teknike për zhvillimin e programit;
 - m. Të dhëna mbi përvojën e mëparshme të strukturave të përfshira në organizimin e formimeve pasuniversitare, nëse ka;
 - n. Modelin e diplomës së studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë”.
3. Studimet e doktoratës organizohen në kuadër të një projekti kërkimor-shkencor dhe realizohen në koordinim me veprimtaritë kërkimore të grupeve përkatëse brenda njësisë bazë. Njësitë përkatëse aplikojnë për financim pranë AKKSHI-së ose institucioneve të tjera financuese vendase apo ndërkombëtare. Kur kandidati është personel akademik me kohë të plotë, studimet mund të mbështeten financiarisht nga fondet e brendshme të UBT-së. Gjithashtu, kandidati mund të vetëfinancohet ose të përfitojë mbështetje nga subjekte të treta, mbi bazën e një deklarami të detajuar të shpenzimeve të kërimit.
 4. Pas miratimit nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të UBT-së, kërkesa për hapjen ose riorganizimin e programit i dërgohet ministrisë përgjegjëse për arsimin, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 9

Afatet dhe procedurat për pranimin në ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë”

1. Njësia kryesore propozon kuotat dhe kriteret e pranimin në programet e studimeve të ciklit të tretë, të cilat diskutohen me njësitë bazë dhe miratohen nga dekanatet, në përputhje me specifikat e fushës dhe standardet shtetërore të cilësisë. Këto kriteret i përcillen Senatit Akademik të UBT-së për miratim përfundimtar.
2. Njësitë kryesore kanë detyrimin të bëjnë publike vendet e lira (kuotat) dhe kriteret e përcaktuara nga njësitë bazë për të gjitha fushat e kërimit shkencor që ofrojnë, si dhe procedurën e përzgjedhjes. Këto kriteret janë të pandryshueshme deri në përfundim të procesit të pranimeve. Kandidati duhet të informohet gjithashtu për kohëzgjatjen e programit të

doktoratës, mbështetjen institucionale dhe ndihmën që i ofrohet nga udhëheqësi shkencor, veçanërisht përgatitjen e disertacionit deri në fazën e mbrojtjes.

3. Kriteret, procedurat dhe afatet për konkurrimin dhe pranimin në programin e studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë” publikohen në faqen zyrtare të internetit të çdo njësie kryesore dhe të UBT-së, si dhe në ambientet fizike të tyre, të paktën një muaj përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të kërkesave për pranim.

Neni 10

Kërkesat themelore dhe procedurat për regjistrimin e kandidatëve

1. Për t’u regjistruar në programin e studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë”, kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme:
 - a. Të ketë përfunduar:
 - i. një program të ciklit të dytë “Master i Shkencave”
 - ii. një program të integruar të nivelit të dytë
 - iii. një diplomë ekuivalente sipas sistemit të vjetër
 - iv. ose një cikël studimi, të barasvlefshëm me ciklet e mësipërme, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë.
 - b. Të jetë punësuar me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të pjesshme në ato raste kur kandidati është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
 - c. Të ketë përfunduar studimet me notë mesatare jo më të ulët se 8.0 (shtatë), e llogaritur si mesatare e thjeshtë e cikleve të studimeve të përfunduara nga kandidati.
 - d. Të zotërojë njohuri në një nga gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht, të vërtetuara përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Nivelet e njohjes përcaktohen sipas tabelës së bashkëlidhur këtij udhëzimi.
 - e. Të ketë dy rekomandime të firmosura nga personel akademik me titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.
2. Përveç kriterëve të përgjithshme, njësitë kryesore, në rregulloret e tyre specifike për programin e studimeve të doktoratës, mund të përcaktojnë edhe kritere të tjera shtesë që lidhen me vlerësimin e kapaciteteve kërkimore-shkencore të kandidatëve.
3. Punonjësit e institucioneve shtetërore, me të cilët UBT ka marrëveshje bashkëpunimi dhe që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre edhe kërkimin shkencor, mund të paraqesin kërkesë për

aplikim në programin e ciklit të tretë, edhe kur nuk plotësojnë kriterin e mesatares të përcaktuar në pikën 1, **shkronja “c”** të këtij neni.

4. Kërkesa duhet të shoqërohet me një shkresë zyrtare nga drejtuesi i institucionit, ku punonjësi është i punësuar, e cila duhet të argumentojë interesin publik të kërkimit shkencor dhe nevojën e institucionit për kualifikimin e punonjësit dhe ngritjen e kapaciteteve humane në tërësi.
5. Këto raste trajtohen si raste përjashtimore dhe vlerësohen nga njësia kryesore, duke marrë në konsideratë kontributin shkencor, përvojën profesionale dhe rëndësinë e fushës së kërkimit. Vendimmarrja bëhet nga Dekananti i Njesisë Kryesore dhe përcillet për miratimin nga Rektori.

Neni 11

Procedura e aplikimit

1. Kandidatët konkurojnë me dosje aplikimi, e cila dorëzohet pranë Zëvendësdekanit për Shkencën të njësisë kryesore. Dosja duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Kërkesën e kandidatit drejtuar njësisë bazë përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e programit të studimeve të ciklit të tretë.
 - b. CV-në personale dhe listë të punimeve shkencore (nëse ka), të dokumentuara.
 - c. Kopje të noterizuara të diplomave universitare të ciklit të parë “Bachelor” dhe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, diplomë të sistemit të vjetër (katërvjeçare ose më tepër), ose diplomë të ekuivalentuar (DIND), së bashku me suplementin ose listën e notave përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vendimin e njohjes/ekuivalentimit nga autoriteti kompetent. Gjithashtu, kopje të noterizuara të diplomave të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, diplomave të specializimit, ose diplomave ekuivalente me to (nëse ka), të shoqëruara me suplementin ose listën e notave;
 - d. Çertifikatë personale dhe fotokopje të noterizuar të kartës së identitetit ose pasaportës
 - e. Dy fotografi
 - f. Dy rekomandime nga persona me titull akademik “Profesor i Asociuar” ose “Profesor”
 - g. Deklaratë të nënshkruar nga kandidati, ku pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare që lidhen me studimet, sipas përcaktimeve të instancave të UBT-së.
 - h. Deklaratë të udhëheqësit shkencor që shpreh gatishmërinë për të udhëhequr kandidatin
 - i. Një propozim ku përcaktohet fusha me interes kërkimor e kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor dhe projekti ku kandidati është i përfshirë (një përshkrim i shkurtër i projektit dhe detaje të buxhetit që mbështet kërkimin e propozuar).
 - j. Dëshmi për zotërimin e një ose më shumë gjuhëve të huaja (origjinale ose noterizuar) në përputhje me udhëzimet në fuqi.

- k. Dëshmi ose vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare, artikuj shkencorë apo pjesëmarrje në konferenca shkencore (nëse ka).
 - l. Mandat pagese që vërteton pagesën e tarifës së aplikimit për konkurrim.
 - m. Vërtetim nga institucioni i punës, që dëshmon se kandidati është i angazhuar si personel akademik në një institucion të arsimit të lartë ose si personel kërkimor në një institucion të kërkimit shkencor, bazë ose të zbatuar.
 - n. Vetëdeklarim të kandidatit që angazhohet të respektojë standardet shkencore dhe etike gjatë gjithë periudhës së studimeve.
2. Aplikimet që nuk përmbajnë të gjithë dokumentacionin e sipër përmendur nuk merren në shqyrtim.
 3. Dokumentet e dorëzuara pranë UBT-së nuk i kthehen aplikantit. Ato ruhen për një periudhë prej gjashtë muajsh nga data e mbylljes së aplikimit dhe më pas arkivohen.
 4. Pas dorëzimit, dokumentacioni i aplikimit nuk mund të ndryshohet ose të plotësohet.

Neni 12

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve

1. Përzgjedhja e kandidatëve kryhet nga njësia kryesore e UBT-së, përgjegjëse për organizimin e programit të doktoratës. Kandidatët që janë personel akademik i punësuar me kohë të plotë në UBT gëzojnë përparësi.
2. Dosja e aplikimit dorëzohet pranë Zëvendësdekanit për Shkencën, i cili kontrollon për plotësimin e dokumentacionit dhe ia përcjell Koordinatorit të programit të ciklit të tretë “Doktoratë” jo më vonë se dy javë nga data e dorëzimit.
3. Pranë njësisë kryesore ngrihet një komision ad-hoc, me vendim Dekanati, me tre deri në pesë anëtarë. Kryetari i komisionit është Koordinatori i programit të ciklit të tretë “Doktoratë”, nëse zotëron titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”. Në rast se Koordinatori nuk plotëson këtë kusht, kryetar emërohet një anëtar tjetër i njësisë bazë me titullin përkatës, ndërsa Koordinatori merr pjesë si anëtar i komisionit. Komisioni përcakton procedurat dhe afatet e vlerësimit të kandidatëve.
4. Vlerësimi i kandidatëve bëhet mbi bazën e:
 - i. mesatares së studimeve të cikleve të studimit
 - ii. prezantimit të projektit të kërkimit shkencor
 - iii. kriterëve të tjera të përcaktuara nga njësia kryesore përkatëse
5. Komisioni ad-hoc, pas verifikimit të dokumentacionit dhe kryerjes së një interviste me secilin kandidat (kur vlerësohet e nevojshme), harton një listë të renditur të kandidatëve, duke përdorur një skemë të qartë dhe transparente të pikëzimit.
6. Brenda një muaji nga mbyllja e aplikimeve, komisioni i përcjell listën e kandidatëve të përzgjedhur njësisë kryesore për shqyrtim dhe miratim.

7. Dekanati i njësisë kryesore, brenda dy javëve nga marrja e listës, miraton kandidatët fitues dhe udhëheqësit shkencorë përkatës, dhe shpall listën përfundimtare të fituesve dhe jo-fituesve.
8. Dekani i njësisë kryesore përcakton afatet e ankimimit për kandidatët e shpallur jo-fitues dhe shqyrton çdo ankesë, duke marrë një vendim përfundimtar.
9. Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit brenda tre (3) ditëve nga data e shpalljes së listës paraprake të fituesve. Ankesa dorëzohet pranë zyrës së protokollit të njësisë kryesore.
10. Pas shqyrtimit të ankesave dhe marrjes së vendimeve përkatëse, njësia kryesore shpall zyrtarisht listën fituese.
11. Nëse kandidati fitues tërhiqet ose nuk kryen regjistrimin brenda afatit të përcaktuar, ai humbet të drejtën për ndjekjen e studimeve të ciklit të tretë. Në vend të tij, regjistrohet kandidati i radhës në listën përfundimtare, brenda një afati tre-ditor.
12. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë së njësisë kryesore përgjegjëse për programin, brenda një periudhe njëjavore nga data e shpalljes së listës përfundimtare. Doktoranti, i regjistruar, pajiset me një numër unik matikulimi (NIM), i cili pasqyrohet në Regjistrin Themeltar të studentëve
13. Në rast se Doktoranti pezullon përkohësisht studimet, NIM-i nuk mbyllet dhe mbetet i pandryshuar deri në rifillimin e programit.
14. Doktorantët e regjistruar atashohen pranë njësisë kryesore përkatëse. Dokumentacioni i aplikimit ruhet në sekretarinë e njësisë kryesore dhe pasurohet gradualisht me të gjitha dokumentet që lidhen me ecurinë e doktorantit gjatë studimeve të doktoratës.

Neni 13

Kapacitetet për udhëheqjen e doktorantëve

1. Studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” udhëhiqen nga personel akademik që zotëron titullin akademik “Profesor i Asociuar” ose “Profesor”. Numri maksimal i doktorantëve që secili mund të udhëheqë njëkohësisht, në varësi të titullit akademik, është si më poshtë:
 - a. Jo më shumë se **tre (3)** doktorantë, në rastin e personelit akademik me titullin “Profesor”.
 - b. Jo më shumë se **dy (2)** doktorantë, në rastin e personelit akademik me titullin “Profesor i Asociuar”.

Neni 14

Të drejtat dhe detyrimet e studentit të doktoratës

Procesi i studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë” përfaqëson një bashkëveprim institucional ndërmjet njësisë bazë, udhëheqësit shkencor dhe doktorantit. Njësia bazë dhe udhëheqësi ofrojnë

mbështetje dhe orientim akademik dhe përgjegjësia për përfundimin e kërkimit shkencor dhe fitimin e gradës shkencore “Doktor” është e doktorantit.

1. Studenti i doktoratës ka këto të drejta:

- a. Të njihet paraprakisht me natyrën, objektivat dhe kufizimet e kërkimit të doktoratës, projektin, afatet e përfundimit dhe stadet kryesore të zhvillimit të tij.
- b. Të kërkojë krijimin e kushteve të përshtatshme për ndjekjen e veprimtarive të parashikuara në programin e studimeve, përfshirë mbështetjen nga departamenti, fakulteti dhe universiteti, sidomos në rastet kur kërkimi kërkon punë në terren.
- c. Të marrë informacion mbi bazën ligjore dhe aktet rregullatore që rregullojnë studimet e doktoratës.
- d. Të këshillohet rregullisht nga udhëheqësi shkencor në intervale të arsyeshme kohore;
- e. Të marrë pjesë në aktivitete kërkimore, konferenca, seminare dhe trajnime që lidhen me fushën e studimit.
- f. Të marrë pjesë si dëgjues apo referues në ligjërata, seminare dhe debate ndërdisiplinore, të organizuara në kuadër të programit të doktoratës ose të veprimtarive postdoktorale, edhe në rastet kur tematika nuk lidhet drejtpërdrejt me projektin personal të kërkimit.
- g. Të shfrytëzojë burimet elektronike dhe bibliotekat e njësisë bazë, njësisë kryesore dhe të UBT-së.
- h. Të aplikojë për pjesëmarrje në mobilitete akademike ose periudha kërkimi në institucione bashkëpunuese të huaja me të cilat UBT ka marrëveshje.
- i. Të tërhiqet nga programi, me vullnetin e tij të lirë, përmes një kërkesë të argumentuar me shkrim.

2. Studenti i doktoratës ka këto detyrime:

- a. Të njohë dhe të zbatojë rregulloren e programit të studimeve të doktoratës të UBT-së, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ciklin e tretë.
- b. Të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.
- c. T’i nënshtrohet një programi mësimor të posaçëm në rastet kur përgatitja e mëparshme akademike, përfshirë dhe rastet e parashikuara në nenin 10, pika 3 dhe 4, nuk lidhet ngushtë me fushën e doktoratës, që nënkupton fitimin e një numri kreditesh në disiplina specifike, në rastet kur vlerësohet e domosdoshme nga udhëheqësi shkencor në dakortësi me koordinatorin e programit.
- d. Të dorëzojë një raport informues, të përgatitur në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor, kur i kërkohet, dhe ta paraqesë atë për miratim pranë njësisë bazë.
- e. Të informojë rregullisht udhëheqësin për ecurinë e kërkimit, publikimet, problematikat dhe të paraqesë pjesë të shkruara të punimit (si raporte progresi, draft kapituj, etj.). Studenti dhe udhëheqësi duhet të realizojnë një vlerësim të përbashkët të punës së kryer të paktën çdo 6 muaj.

- f. Të shlyejë në kohë detyrimet financiare ndaj njësisë kryesore, të lidhura me regjistrimin dhe ndjekjen e studimeve.
- g. Të paraqesë të paktën një herë në vit, në njësinë bazë, një raport të shkruar mbi ecurinë e programit të studimeve.
- h. Të respektojë standardet shkencore dhe etike të kërkimit, duke shmangur manipulimin e të dhënave, falsifikimin e rezultateve, plagjiaturën, dhe përfshirjen e emrave që nuk kanë kontribuar realisht në kërkim.
- i. Të përmbushë programin e miratuar të kërkimit dhe të përfundojë disertacionin brenda afateve të përcaktuara.

Neni 15

Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor

Udhëheqësi shkencor kryesor dhe udhëheqësi tjetër (*në rastin e bashkëudhëheqjes ose të programeve të ofruara në bashkëpunim ndërmjet më shumë se një njësie universitare*) kanë për detyrë të:

1. Zbatojnë rregullat shkencore dhe etike gjatë gjithë procesit të udhëheqjes së doktorantit.
2. Hartojnë, në bashkëpunim me studentin, metodologjinë e kërkimit dhe planin e zhvillimit të aktiviteteve kërkimore, në përputhje me projektin. Ky plan diskutohet në grupin mësimor-kërkimor pranë njësisë bazë ku studenti është i atashuar dhe përfshin:
 - a. Përshkrimin e plotë të projektit dhe të detyrave kërkimore.
 - b. Planin e progresit për përfundimin e komponentit kërkimor.
 - c. (*Nëse është e aplikueshme*) planin për qëndrime në universitete apo institucione kërkimore, brenda ose jashtë vendit.
 - d. Planin e publikimeve dhe referimeve shkencore.
3. Bashkëpërgatisin me studentin raportin vjetor të progresit, i cili shqyrtohet dhe miratohet çdo vit akademik nga grupi mësimor-kërkimor pranë njësisë bazë.
4. Sigurojnë mbështetje akademike të vazhdueshme dhe këshillim shkencor për doktorantin, me qëllim arritjen e standardeve të larta të kërkimit shkencor, duke përfshirë:
 - a. Ndihmën për formulimin e titullit të punimit, përgatitjen e projekt-propozimit dhe platformës së kërkimit.
 - b. Rekomandimin e literaturës dhe burimeve të informacionit.
 - c. Këshillimin mbi organizimin e të dhënave dhe përgatitjen e disertacionit.
 - d. Mbikëqyrjen e zbatimit të planit të miratuar dhe përfundimit të tij në kohë.
5. Informojë doktorantin për rëndësinë e zbatimit të rregullave të etikës në kërkimin shkencor, përfshirë shmangien e plagjiaturës.
6. Organizojnë takime të rregullta me studentin për të vlerësuar ecurinë e punës kërkimore dhe ndërmarrin masat e nevojshme mbështetëse në kohë.

7. Në rastet e bashkëudhëheqjes, qartësojnë ndarjen e përgjegjësiave dhe mbajnë kontakte të rregullta për bashkërendimin e procesit të udhëheqjes.
8. Realizojnë vlerësimin vjetor të progresit të studentit, përmes një raporti të shkruar të paraqitur nga ky i fundit, si dhe monitorojnë përputhshmërinë e punës me standardet shkencore.
9. Mbështesin studentin në përgatitjen dhe prezantimin e rezultateve kërkimore në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit, përfshirë referimet e hapura në grupin mësimor-kërkimor të njësisë bazë.
10. Ndihmojnë studentin në shkrimin e artikujve shkencorë që rrjedhin nga puna kërkimore, duke respektuar marrëveshjet për autorësinë akademike.
11. Vlerësojnë çdo material të paraqitur nga kandidati për mbrojtje, bazuar në këto kritere:
 - a. Rëndësia e temës së trajtuar
 - b. Qartësia e objektivave të kërkimit
 - c. Origjinaliteti i qasjes dhe diskutimit shkencor
 - d. Cilësia shkencore e analizës dhe përpunimit të të dhënave
 - e. Përdorimi i metodologjisë së saktë dhe të argumentuar
 - f. Saktësia e përfundimeve dhe kontributi i tyre në fushën përkatëse
 - g. Ballafaqimi kritik ndërmjet konkluzioneve të studentit dhe literaturës ekzistuese
 - h. Aftësia krijuese dhe përqasja e pavarur kërkimore e studentit
 - i. Paraqitja e qartë e kufizimeve të studimit
 - j. Struktura e balancuar dhe koherente e disertacionit.
12. Verifikojnë që kandidati ka zbatuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e jurisë në rastet kur punimi është rikthyer për rishqyrtim para mbrojtjes.

Neni 16

Përgjegjësitë e Koordinatorit të programit të studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë”

Koordinatori i programit të doktoratës, në bashkëpunim me strukturat akademike dhe administrative përkatëse të njësisë kryesore, ka përgjegjësi për të garantuar funksionimin cilësor dhe ligjor të programit. Detyrat e tij përfshijnë:

1. Të përditësojë në mënyrë periodike fushat e gjera të kërkimit që mbulohen nga grupi i njësive bazë që ofrojnë programin e studimeve të ciklit të tretë.
2. Të sigurojë respektimin e të gjitha rregullave dhe kritereve për caktimin e udhëheqësit shkencor të doktoratës.
3. Të garantojë që udhëheqësit e propozuar për doktoratë janë ekspertë në fushën përkatëse të kërkimit, plotësojnë kriteret e kualifikimit akademik, zotërojnë kohën dhe kapacitetin për të ofruar mbështetje shkencore cilësore dhe menaxhim efektiv të punës së doktorantit.

4. Të sigurojë që udhëheqësit shkencorë të kenë në udhëheqje numrin e doktorantëve të parashikuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje.
5. Të garantojë zbatimin e standardeve të kërkimit shkencor në zhvillimin e programeve të doktoratës.
6. Të shqyrtojë raportet e progresit të dorëzuara nga studentët dhe udhëheqësit shkencorë, dhe të sigurojë që udhëheqësi ka kontakte të rregullta me doktorantin. Në rast konstatimi të problematikave, Koordinatorin i propozon njësisë bazë ndërhyrjet apo ndryshimet e nevojshme.
7. Të sigurojë që procedurat e mbikëqyrjes dhe të vlerësimit të ecurisë së kërkimit të jenë të dokumentuara dhe në përputhje me aktet rregullatore.
8. Të informojë studentët e doktoratës për të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzimet, rregulloret dhe procedurat që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.
9. Së bashku me Administratorin e Fakultetit, të ndjekë realizimin e pagesave periodike për udhëheqësit shkencorë, sipas procedurave dhe dokumentacionit përkatës.

Neni 17

Përgjegjësitë e njësisë bazë për studentët e doktoratës

1. Njësia bazë, pranë së cilës studenti i doktoratës zhvillon kërkimin shkencor, është përgjegjëse për zhvillimin e punës kërkimore-shkencore, si dhe për të gjitha fazat e procesit të studimeve të ciklit të tretë.
2. Njësia bazë propozon fushat dhe nënfushat e kërkimit shkencor ku do të zhvillohen projektet e doktoraturës.
3. Njësia bazë ka përgjegjësi të sigurojë lehtësitë administrative dhe akademike për studentët doktorantë, duke garantuar akses në informacionin e nevojshëm, literaturën shkencore dhe një mjedis të përshtatshëm intelektual e fizik. Gjithashtu, ka për detyrë t'i njohë ata me rregulloret dhe kërkesat e UBT-së për programin e doktoratës.
4. Të sigurojë kapacitete të mjaftueshme për të mbështetur studentin deri në përfundim të programit. Nëse udhëheqësi shkencor mungon për më shumë se tre (3) muaj ose largohet për arsye ligjore, njësia bazë merr masa për caktimin e një udhëheqësi alternativ ose bashkëudhëheqësi, të pranueshëm nga studenti. Po ashtu, ajo është përgjegjëse për zgjidhjen e situatave kur marrëdhënia ndërmjet udhëheqësit dhe studentit nuk funksionon.
5. Në rastet kur ndodh ndërprerja e udhëheqjes për arsye të:
 - a. pamundësisë fizike ose mendore të udhëheqësit
 - b. zgjidhjes së kontratës së punës
 - c. dorëheqjes së justifikuar nga ana e udhëheqësit
 - d. ose mosfunksionimit të marrëdhënies udhëheqës-student

Njësia bazë cakton menjëherë një udhëheqës të ri (ose bashkëudhëheqës), duke ia propozuar emërimin Dekanatit për miratim.

6. Zëvendësimi i udhëheqësit shkencor bëhet jo më vonë se viti i dytë i studimeve të doktoratës, me qëllim që ecuria e programit të mos cënohet.
7. Njësia bazë duhet të sigurojë që tema e kërkimit të jetë brenda fushës së ekspertizës së udhëheqësit, si në aspektin metodologjik ashtu edhe teorik.
8. Ka për detyrë të monitorojë progresin e doktorantit, në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësin shkencor, dhe të sigurojë raportime periodike gjatë gjithë periudhës së studimeve.
9. Inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në seminare shkencore dhe krijon mundësi për integrimin e tyre në mjedisin kërkimor të njësisë bazë, grupit studimor dhe disiplinës përkatëse, përmes organizimit të sesioneve të rregullta shkencore.
10. Njësia bazë shqyrton kërkesën e doktorantit për ndryshimin e temës së disertacionit. Doktoranti i paraqet përgjegjësit të njësisë bazë një raport të firmosur nga ai dhe udhëheqësi shkencor, ku arsyetohet ndryshimi. Vendimarrja për miratimin ose jo të ndryshimit merret nga njësia bazë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga dorëzimi i kërkesës.

Neni 18

Përgjegjësitë e Zëvendësdekanit për Shkencën

Programet e studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë”, drejtohen dhe mbikëqyren nga Zëvendësdekani për Shkencën, i cili ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Të sigurojë dhe të mbikëqyrë respektimin, nga ana e njësive bazë, të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, të kësaj Rregulloreje dhe të standardeve të cilësisë, në drejtim të:
 - a. Respektimit të afateve dhe kriterëve për shpalljen e thirrjes për aplikim në programin e doktoratës.
 - b. Respektimit të rregullave për përzgjedhjen dhe pranimin e kandidatëve fitues.
 - c. Zbatimit të kriterëve për caktimin e udhëheqësve shkencorë, numrin maksimal të doktorantëve që mund të udhëhiqen nga stafi akademik, përputhjen e ekspertizës me fushën e kërkimit, si dhe aftësinë për të ofruar mbështetje cilësore akademike.
 - d. Respektimit të procedurave të mbikëqyrjes dhe të vlerësimit të ecurisë së kërkimit shkencor.
2. Të ndjekë procedurën e pranimin të dosjeve të kandidatëve për regjistrim në programin e doktoratës, duke kryer verifikimin paraprak të dokumentacionit dhe duke raportuar në Dekanat.
3. Të përgatisë dosjet e kandidatëve për shqyrtim dhe t'i përcjellë tek Koordinatori i programit pjesë e komisionit ad-hoc.

4. Të koordinojë punën ndërmjet komisioneve ad-hoc, njësive bazë dhe KGSHD-së dhe të hartojë materialin përfundimtar për miratim në Dekanat, duke përfshirë edhe listën përfundimtare të kandidatëve fitues.
5. Të mbledhë ankesat e kandidatëve dhe t'i dërgojë në Dekanat për shqyrtim.
6. Të ndjekë kualifikimet specifike të çdo studenti të doktoratës, në bashkëpunim me përgjegjësit e njësive bazë dhe udhëheqësit shkencorë.
7. Të bashkëpunojë dhe të koordinojë punën me përgjegjësit e njësive bazë dhe me udhëheqësin e çdo studenti, për monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së studimeve dhe kërkimit.
8. Të hartojë grafikët e paraqitjeve të punës shkencore të studentëve dhe të bëjë publike këto sesione në bashkërendim me njësitë bazë përkatëse.
9. Të shqyrtojë raportet e progresit të dorëzuara nga studentët dhe udhëheqësit shkencorë dhe të garantojë që ekziston një komunikim i rregullt ndërmjet tyre. Kur konstatohen problematika, Zëvendësdekani i propozon drejtuesit të njësisë kryesore marrjen e masave përkatëse.
10. T'i informojë studentët e doktoratës për të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi, që lidhen me përfitimin e gradës shkencore.
11. Të kontrollojë përmbushjen e të gjitha kriterëve që lidhen me dosjen përfundimtare të studentit, përfshirë edhe disertacionin e dorëzuar, dhe të ndjekë procedurat për miratimin e saj nga drejtuesi i njësisë kryesore.
12. Të paraqesë për miratim në Komisionin për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” të njësisë kryesore dosjen përfundimtare të studentit, të shoqëruar me një relacion të detajuar mbi veprimtarinë shkencore të doktorantit dhe përmbushjen e të gjitha kërkesave për mbrojtje.
13. Të ndjekë respektimin e afateve kohore për përfundimin e doktoratës, sipas kësaj Rregulloreje.
14. Të krijojë dhe të administrojë një bazë të dhënash institucionale për të gjithë veprimtarinë e programit të doktoratës në njësinë kryesore, e cila do të shërbejë për planifikimin, monitorimin dhe koordinimin e kërkimit shkencor në vazhdimësi.

Neni 19

Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”

1. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” ngrihet në nivel njësie kryesore dhe është organ kolegjal përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të dhënies së gradës shkencore “Doktor”, në përputhje me kuadrin ligjor dhe këtë Rregullore.
2. Komisioni përbëhet nga **pesë (5)** anëtarë, të cilët zgjidhen me vetëkandidim nga radhët e Asamblesë së Personelit Akademik të njësisë kryesore. Të gjithë anëtarët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a. të kenë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”

- b. të kenë të paktën **pesë (5)** vite përvojë pune me kohë të plotë si personel akademik pranë UBT-së.
- 3. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dosjes së kandidatit për gradën “Doktor” dhe, nëse ajo përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbush kriteret e kësaj Rregulloreje, komisioni ngre jurinë e mbrojtjes me **pesë (5)** anëtarë, me propozim të njësisë bazë nga vjen kandidati, **brenda tridhjetë (30) ditëve** nga data e marrjes së dosjes për shqyrtim.
- 4. Anëtarësia në Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” është e papajtueshme me ushtrimin e funksioneve të mëposhtme:
 - a. Drejtues i njësisë kryesore
 - b. Drejtues i njësisë bazë përgjegjëse për programin e doktoratës
 - c. Koordinator i programit të doktoratës.
- 5. Komisioni harton Rregulloren e funksionimit të tij të brendshëm, e cila miratohet nga Dekananti i njësisë kryesore.

Neni 20

Afati i përfundimit të studimeve të doktoratës

- 1. Studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” zgjasin jo më pak se tre (3) vite dhe jo më shumë se pesë (5) vite akademike. Në përfundim të studimeve, kandidatit i jepet diploma për përfitimin e gradës shkencore “Doktor”.
- 2. Afati i përfundimit të studimeve mund të zgjatet në rastet kur kandidati përballlet me rrethana të justifikuar, të dokumentuara dhe të jashtëzakonshme, si: sëmundje të rënda dhe afatgjata, fatkeqësi të paparashikuara, leje lindjeje apo situata të tjera të paparashikuara. Kërkesa për zgjatje mund të paraqitet deri në dy (2) herë, secila për një afat jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj.
- 3. Kërkesa për zgjatje ose pezullim të studimeve të doktoratës paraqitet nga kandidati me shkrim dhe duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës justifikues, si dhe me miratimin me shkrim të udhëheqësit shkencor. Vendimi për pranimin ose refuzimin e kërkesës merret nga Dekanati.
- 4. Nëse disertacioni nuk paraqitet për fillimin e procedurës së mbrojtjes edhe brenda afatit të zgjatur, dhe nuk ka një justifikim bindës, Dekanati, me propozim të njësisë bazë, vendos çregjistrimin e studentit nga programi i doktoratës.
- 5. Në rastet e shkeljes së etikës akademike, të afateve, mungesës së vazhdueshme të progresit shkencor, apo ndryshimeve madhore dhe të paarsyetuara të projektit të kërkimit, njësia bazë

ka të drejtë t'i propozojë Dekanit të njësisë kryesore çregjistrimin e studentit nga programi i doktoratës. Vendimi për çregjistrimin e studentit nga programi i doktoratës, merret nga Dekanati pas vlerësimit të dokumentacionit përkatës.

Neni 21

Organizimi i programeve të përbashkëta të doktoratës

1. Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) mund të organizojë programe të përbashkëta të studimeve të doktoratës me institucione të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit, mbi bazën e një marrëveshjeje dypalëshe. Marrëveshja përcakton detajet e funksionimit të programit të përbashkët, përfshirë: të dhënat e kandidatit, temën e studimit, përcaktimin e udhëheqësve shkencorë në secilin institucion, afatet kohore, vendin e realizimit të studimeve, detyrimet akademike dhe financiare të palëve, si dhe modalitetet e mbrojtjes së disertacionit.
2. Marrëveshja firmoset nga:
 - a. Drejtuesi i njësisë bazë
 - b. Drejtuesi i njësisë kryesore
 - c. Rektori i UBT-së
 - d. si dhe përfaqësuesit përkatës të institucionit partner
3. Njësia bazë miraton udhëheqësin ose bashkëudhëheqësin shkencor të doktoratës. Pas miratimit, një kopje e dosjes së doktorantit depozitohet pranë drejtuesit të programit të doktoratës në njësinë kryesore, së bashku me detyrimet e përcaktuara në marrëveshje.
4. Kandidati, udhëheqësi dhe institucionet partnere janë të detyruar të respektojnë politikat përkatëse institucionale për pronësinë intelektuale, mbrojtjen e të dhënave të kërkimit dhe publikimin e rezultateve.
5. Programi i doktoratës dhe përgatitja e disertacionit realizohen me periudha të alternuara në secilin institucion pjesëmarrës.
6. Secili doktorant duhet të ketë dy udhëheqës shkencorë, një nga secili institucion partner.
7. Procedurat e mbrojtjes dhe dokumentacioni shoqërues përcaktohen në marrëveshjen e programit të përbashkët të ciklit të tretë midis institucioneve.
8. Procedurat, në rastin e kërkesave për bashkëudhëheqje, që nuk janë pjesë e programeve të përbashkëta të doktoratës, përcaktohen me vendim të veçantë nga Rektori.

Neni 22

Ndërkombëtarizimi i programit të studimeve të doktoratës

1. Në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të doktoratës, pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës mund të regjistrohen kandidatë të huaj për studimet e ciklit të tretë, të cilët vijnë nga:
 - a. Kosova, trojet shqiptare dhe diaspora shqiptare
 - b. Vendet e rajonit të Ballkanit
 - c. Vendet anëtare të Bashkimit Evropian
 - d. Vende të tjera të botës
2. Programi i doktoratës duhet të nxisë dhe të mbështesë mobilitetin ndërkombëtar të studentëve të doktoratës, duke mundësuar, në përputhje me mundësitë buxhetore të institucionit:
 - a. Pjesëmarrjen e doktorantëve në periudha formimi akademik jashtë vendit
 - b. Prezantimin e rezultateve të kërkimit shkencor në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare si: konferenca, simpoziume, kongrese shkencore, etj.
3. Njësia përgjegjëse për organizimin e programit të doktoratës duhet të ketë të paktën një marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi me një institucion të arsimit të lartë në një nga vendet anëtare të **BE-së, OECD-së** ose **G20-ës**, marrëveshje e cila garanton:
 - a. shkëmbimin e personelit akademik dhe të doktorantëve
 - b. zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore
 - c. organizimin e mobiliteteve dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për përmirësimin e cilësisë së kërkimit shkencor.
4. Programi i doktoratës mund të përfshijë zhvillimin e **moduleve të posaçme** që ofrojnë studime të thelluara teorike në fushën përkatëse të kërkimit, duke përfshirë edhe kontributin e stafit akademik të institucioneve partnere ndërkombëtare.

Neni 23

Veçoritë e organizimit të programeve ndërdisiplinore të doktoratës

1. Njësitë kryesore të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) mund të organizojnë programe ndërdisiplinore të studimeve të doktoratës në bashkëpunim me një ose më shumë fakultete të tjera të UBT-së, duke respektuar kriteret e mëposhtme:
 - a. Programi i studimeve dhe përgatitja e disertacionit realizohen në mënyrë të alternuar në secilën prej njësive kryesore pjesëmarrëse.
 - b. Fusha e kërkimit të jetë e afërt ose ndërdisiplinore, në mënyrë që të sigurohet koherencë tematike dhe metodologjike ndërmjet disiplinave të përfshira.
 - c. Caktohen dy udhëheqës shkencorë, nga një për secilën njësi kryesore pjesëmarrëse në programin ndërdisiplinor.
 - d. Vlerësimi pozitiv nga të dy udhëheqësit shkencorë është kusht i domosdoshëm për vijimin e procedurës së mbrojtjes së disertacionit.
 - e. Anëtarët e jurisë për mbrojtjen e disertacionit caktohen me vendim të përbashkët të KGSHD-vë të njësive kryesore pjesëmarrëse.

- f. Programi ndërdisiplinor përfundon me lëshimin e një diplome të vetme për gradën shkencore “Doktor”, e cila është e përbashkët dhe e regjistruar njëkohësisht në të dy njësitë pjesëmarrëse. Në diplomë shënohet qartë: ***“Doktoratë në bashkëpunim me Fakultetin ...”***.

Neni 24

Kërkesat themelore për realizimin e programit të studimeve të doktoratës

1. Studentët e regjistruar në programin e studimeve të doktoratës, gjatë viteve të rregullta të studimeve, janë të detyruar të zhvillojnë veprimtari akademike dhe kërkimore në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe në këtë rregullore.

Viti i parë i studimeve

2. Gjatë vitit të parë, doktoranti kryen aktivitetet e mëposhtme:
 - a. Kërkim dhe analizë të detajuar të literaturës bazë dhe asaj specifike, mbi të cilën mbështetet projekti kërkimor i miratuar për t’u zhvilluar.
 - b. Hartim të metodologjisë të kërkimit shkencor dhe raportimin e saj pranë njësisë bazë përgjegjëse, së bashku me literaturën e shqyrtuar. Prezantimi i këtij materiali bëhet brenda muajit të 11-të të vitit të parë të studimeve.

Viti i dytë i studimeve

3. Gjatë vitit të dytë të studimeve, doktoranti kryen këto veprimtari:
 - a. Zhvillim të plotë të kërkimit shkencor, përfshirë eksperimente, analiza, anketime apo hulumtime të tjera të parashikuara në projektin dhe platformën e kërkimit, nën drejtimin e udhëheqësit shkencor.
 - b. Reflektim të rezultateve të kërkimit në publikime shkencore (artikuj, pjesëmarrje në konferenca), në përmbushje të kushteve për marrjen e gradës “Doktor”. Në përfundim të vitit të dytë, kandidati harton një raport vjetor mbi progresin e kërkimit dhe produktet e realizuara, i cili prezantohet në njësinë bazë jo më vonë se muaji i 12-të i vitit të dytë.

Viti i tretë i studimeve

4. Gjatë vitit të tretë të studimeve, doktoranti kryen:
 - a. Përfundimin e plotë të veprimtarisë kërkimore.
 - b. Përgatitjen dhe hartimin e disertacionit të doktoratës

- c. Plotësimin e dosjes së disertacionit me dokumentacionin e kërkuar në përputhje me këtë Rregullore.
5. Njësia bazë monitoron ecurinë e punës së kandidatit gjatë gjithë periudhës së studimeve, bazuar në raportimet vjetore, prezantimet shkencore dhe produktet e realizuara si: publikime shkencore, pjesëmarrje në aktivitete kërkimore, etj.

Neni 25

Ndryshimi i udhëheqësit shkencor

1. Kandidati i doktoratës ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e udhëheqësit shkencor në rastet kur ky i fundit nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në nenin 15, pika 2/a–d; pika 3; pika 4/a–d dhe pika 6 të kësaj Rregulloreje.
2. Kërkesa për ndryshimin e udhëheqësit shkencor duhet të jetë e argumentuar dhe e mbështetur me prova dokumentare, të cilat vërtetojnë qartë mosrespektimin e detyrimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni.
3. Ndryshimi i udhëheqësit shkencor mund të bëhet gjithashtu edhe në rastet e parashikuara në nenin 17, pika 7/a të kësaj Rregulloreje (si: pamundësi fizike ose mendore, përfundim kontrate, dorëheqje e argumentuar, etj.).
4. Doktoranti ka të drejtë që, brenda vitit parë të studimeve, të paraqesë me shkrim kërkesën për ndryshimin e udhëheqësit pranë drejtuesit të njësisë bazë. Drejtuesi i njësisë bazë e shqyrton kërkesën dhe brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve i paraqet dekanatit të njësisë kryesore një propozim të arsyetuar me shkrim. Dekanati shprehet me vendim përfundimtar brenda 15 ditëve nga marrja e propozimit.
5. Në rast se kërkesa miratohet, njësia bazë, në bashkëpunim me kandidatin, propozon një udhëheqës të ri në të njëjtën fushë ose nënfushë të projektit ekzistues të doktoratës. Nëse kjo nuk është e mundur dhe kërkon ndryshimin e projektit kërkimor, kandidati i jepet mundësia të hartojë një projekt të ri brenda së njëjtës fushë shkencore, në përputhje me strukturën e projektit të programit të doktoratës të miratuar. Projekti i ri i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit dhe miratimit, sipas kësaj Rregulloreje.
6. Doktoranti dhe udhëheqësi i ri shkencor përgatisin programin e realizimit të veprimtarive kërkimore për projektin e ri, në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe brenda afateve të përcaktuara. Programi duhet të garantojë përmbushjen e plotë të veprimtarive akademike në një periudhë minimale prej tre (3) vitesh, duke filluar nga data e miratimit nga Komisioni përkatës.
7. Procedura për miratimin e ndryshimit të temës së doktoratës dhe të projektit kërkimor të doktorantit zhvillohet sipas të njëjtave procedura të parashikuara për ndryshimin e udhëheqësit shkencor dhe vetëm pasi janë marrë miratimet përkatëse zyrtare.

Neni 26

Ndryshimi i temës kërkimore të disertacionit

1. Në rastet kur ekzistojnë nevoja dhe arsye objektive për ndryshimin e temës së disertacionit, Doktoranti paraqet një kërkesë të argumentuar me shkrim pranë përgjegjësit të njësisë bazë. Kërkesa duhet të jetë e nënshkruar nga vetë kandidati dhe e miratuar nga udhëheqësi ose udhëheqësit shkencorë, dhe duhet të dorëzohet përpara dorëzimit të raportit të parë të kërimit në njësinë bazë.
2. Kërkesa për ndryshimin e temës duhet të jetë e mbështetur në argumente shkencore dhe ligjore, të cilat provojnë pamundësinë e zhvillimit të projektit kërkimor të miratuar fillimisht. Kërkesa duhet të përmbajë një shpjegim të qartë të arsyeve ligjore dhe shkencore që kanë çuar në kërkesën për ndryshim.
3. Pas shqyrtimit të kërkesës, përgjegjësi i njësisë bazë harton një raport të detajuar, ku analizohen arsyet e paraqitura nga kandidati dhe vlerësohet nevoja për ndryshimin e temës. Ky raport, së bashku me propozimin përkatës, i përcillet drejtuesit të njësisë kryesore jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e dorëzimit të kërkesës.
4. Dekanati i njësisë kryesore, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e propozimit, miraton ose refuzon ndryshimin e temës, duke u shprehur me një vendim të arsyetuar dhe me shkrim.

Neni 27

Etika në kërkimin shkencor

1. Çdo disertacion duhet të respektojë parimet e etikës në kërkimin shkencor dhe të integritetit akademik, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me Kodin e Etikës dhe rregulloret përkatëse të UBT-së.
2. Kandidati i doktoratës duhet të deklarojë me shkrim, në një formular të posaçëm se:
 - punimi përfaqëson kërkim origjinal të tij
 - ka respektuar të gjitha rregullat për shmangien e plagjiaturës
 - nuk ka përfshirë në punim pjesë të kopjuara apo të përdorura pa citimin e duhur
3. Të gjitha kërkimet shkencore që përfshijnë eksperimente in vivo (përfshirë njerëz ose kafshë), duhet të jenë në përputhje të plotë me ligjin shqiptar dhe me standardet ndërkombëtare etike në kërkim. Në këto raste:
 - kërkohet miratim paraprak me shkrim nga Këshilli i Etikës i UBT-së
 - si dhe nga çdo institucion tjetër i përfshirë në kërkim, nëse kërkimi zhvillohet në bashkëpunim apo jashtë UBT-së.

4. Pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit mbi disertacionin dhe çdo material të botuar që rrjedh prej tij është e mbrojtur sipas ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, si dhe akteve të tjera përkatëse në fuqi.
5. Në faqen pas titullit të disertacionit, duhet të vendoset një shënim për rezervimin e së drejtës së autorit, duke përfshirë:
 - simbolin për të drejtën e autorit (©)
 - emrin e autorit (doktorantit)
 - vitin e përfundimit të disertacionit
 - formulimin: “Të gjitha të drejtat e rezervuara”

Neni 28

Kriteret bazë që duhet të plotësojë kandidati përpara mbrojtjes së disertacionit

1. Përpara paraqitjes për mbrojtje, doktoranti duhet të ketë përmbushur kriteret e mëposhtme:
 - a. Të ketë realizuar, si autor i parë ose i dytë (nëse autori i parë është udhëheqësi shkencor), të paktën tre (3) referime shkencore, prej të cilave dy (2) duhet të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpoziume, konferenca apo kongrese) në një nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës. Referimet duhet të jenë të pranuar në bazë të një vlerësimi shkencor paraprak dhe të botuara në “Proceedings” me kod ISBN ose ISSN. Ato duhet të reflektojnë aspekte të qarta të projektit të doktoratës dhe realizimit të tij.
 - b. Të ketë botuar të paktën tre (3) artikuj shkencorë në revista të indeksuara brenda ose jashtë vendit. Të paktën një (1) nga këto artikuj duhet të jetë i botuar në një revistë ndërkombëtare të indeksuar në Scopus (me CiteScore ose SJR) dhe/ose në Web of Science (me faktor ndikimi IF ose JCI), ku është së paku autor i dytë, kur autor i parë është udhëheqësi shkencor. Artikujt duhet të trajtojnë rezultate të drejtpërdrejta të kërimit shkencor të zhvilluar gjatë studimeve të doktoratës.
 - c. Të ketë realizuar tre (3) referime të plota në njësinë bazë, përveç referimit fillestar për metodologjinë. Në referimin e tretë duhet të përfshihen të dhënat përfundimtare të vitit të tretë si dhe një përmbledhje e rezultateve të përgjithshme të kërimit. Të gjitha referimet dhe botimet duhet të lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit të miratuar të doktoratës.
 - d. Të ketë përfunduar disertacionin sipas formatit të përcaktuar në nenin 31 të kësaj Rregulloreje. Disertacioni duhet të jetë i përputhshëm me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, si dhe me aktet e brendshme të miratuara nga UBT lidhur me etiken dhe integritetin në kërkimin shkencor.

2. Koordinator i programit të doktoratës, së bashku me departamentin ose grupin mësimor-shkencor përkatës, shqyrtojnë progresin dhe përmbushjen e detyrimeve akademike të doktorantit, përpara kalimit në fazën e mbrojtjes.
3. Disertacioni duhet të përfundohet brenda afateve të përcaktuara në këtë Rregullore dhe të dorëzohet:
 - i. në format të shtypur dhe elektronik (CD)
 - ii. së bashku me dosjen dokumentare, e cila përmban provat e përmbushjes së kritereve të sipërpërmendura.
 - iii. pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili e përcjell për vlerësim në njësinë bazë, në funksion të nisjes së procedurës për mbrojtje.

Në dosje duhet të përfshihet gjithashtu edhe:

 - i. një autoreferat (përmbledhje) i miratuar paraprakisht dhe i firmosur nga udhëheqësi shkencor.
 - ii. raporti i kontrollit antiplagjiaturë, në përputhje me VKM nr. 777/2018 dhe aktet nënligjore përkatëse.

Neni 29

Procedura e ndjekur për mbrojtjen e disertacionit

1. Kandidati dorëzon disertacionin, së bashku me dosjen, pranë drejtuesit të njësisë kryesore i cili ja përcjell për vlerësim njësisë bazë brenda 15 (pesëmbëdhjetë ditëve) nga data e dorëzimit.
2. Njësia bazë shqyrton dosjen e kandidatit, mbështetur në dokumentacionin dhe arritjet e doktorantit dhe harton për secilin doktorant një raport përfundimtar vlerësues i cili vërteton përmbushjen e të gjitha kritereve të kërkuara nga kjo Rregullore. Nëse dosja vlerësohet si e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe institucionale, dhe pas votimit nga anëtarësia e njësisë bazë, ajo:
 - i. i përcjell zyrtarisht, disertacionin dhe dosjen KGSHD-së, nëpërmjet Zëvendësdekanit për shkencën brenda 30 (tridhjetë) ditëve.
 - ii. i përcjell zyrtarisht, drejtuesit të njësisë kryesore, propozimin për përbërjen e jurisë së mbrojtjes me jo më pak se 8 (tetë) anëtarë brenda 20 (tridhjetë) ditëve.
3. Zëvendësdekani për shkencën, i njësisë kryesore, relatton dosjen pranë Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” (KGSHD), shoqëruar me një raport.
4. KGSHD, brenda 30 ditëve nga relati i dosjes:
 - i. në rast vlerësimi pozitiv, përcakton përbërjen e jurisë me 5 (pesë) anëtarë, dhe ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore dhe Rektorit nëpërmjet zyrës së shkencës.

- ii. në rast vlerësimi negativ, kthen dosjen pranë njësisë kryesore, së bashku me një relacion të arsyetuar me shkrim mbi arsyet e mosmiratimit.
- 5. Pas miratimit përfundimtar të Jurisë, vendimi i përcillet kryetarit të jurisë për organizimin e procesit të mbrojtjes publike të disertacionit.
- 6. Pas përfundimit të mbrojtjes, kryetari i jurisë i kthen dosjen drejtuesit të njësisë kryesore, i cili, në bashkërendim me Drejtorinë e Shkencës dhe Promovimit Akademik, procedon me:
 - i. regjistrimin e gradës shkencore në Regjistrin Shtetëror
 - ii. lëshimin e diplomës për fitimin e gradës shkencore “Doktor”

Neni 30

Disertacioni

1. Vlerësimi përfundimtar i studentit të doktoratës bazohet kryesisht në vlerësimin shkencor të produktit kërkimor të tij, konkretisht të disertacionit.
2. Rezultatet e kërkimit paraqiten në formën e një disertacioni, i cili duhet të:
 - ketë nivel të lartë shkencor
 - paraqesë qartësisht formulimin e objektivave dhe hipotezave kërkimore
 - mbështetet në një bazë konceptuale dhe teorike të strukturuar
 - përfshijë metodologji të dokumentuar, përdorim korrekt të literaturës shkencore
 - si dhe të demonstrojë aftësi për argumentim dhe prezantim profesional të kërkimit përpara jurisë së mbrojtjes.
3. Disertacioni duhet të kontribuojë në zhvillimin e njohurive të reja teorike në fushën përkatëse dhe të ketë cilësi akademike të tillë që të justifikojë botimin në literaturën shkencore përkatëse.

Neni 31

Struktura e disertacionit

1. Në kuadër të përgatitjes së disertacionit dhe formatimit të tij, doktoranti i referohet një prej formateve shkencore të njohura ndërkombëtarisht. Formatet dhe shabllonet në kuadër të formatimit të disertacionit do të përcaktohen me udhëzime përkatëse nga Drejtoria e Shkencës dhe Promovimit në UBT.

Neni 32

Dorëzimi i disertacionit dhe ngritja e Jurisë

1. Juria për vlerësimin dhe mbrojtjen e disertacionit ngrihet vetëm pasi doktoranti ka përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe në këtë rregullore.
2. Dosja e kandidatit për marrjen e gradës shkencore “Doktor” dorëzohet pranë drejtuesit të njësisë bazë, së bashku me një kërkesë zyrtare për fillimin e procedurës së mbrojtjes, të nënshkruar nga kandidati dhe udhëheqësi shkencor.
3. Dosja duhet të përmbajë:
 - 3 (tre) kopje të disertacionit në format të printuar (hardcopy);
 - 1 (një) kopje elektronike në CD. Pas dorëzimit, dosja nuk mund të tërhiqet përpara vendosjes së datës për mbrojtjen publike të disertacionit.
4. Në rast se njësisë bazë jep vlerësim negativ, doktoranti ka të drejtë të riparaqesë disertacionin dhe dosjen e plotësuar, jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e vlerësimit negativ.
5. Në rast vlerësimi pozitiv, Komisioni i Gradës Shkencore Doktor, përcakton përbërjen e Jurisë me 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) duhet të jenë nga institucione akademike homologe vendase ose të huaja.
6. Anëtarët e Jurisë duhet të kenë titullin “Profesor”. Në kushtet e mosplotësimit të këtij kushti, lejohet që të paktën 3 (tre) prej anëtarëve të kenë titullin “Profesor” dhe 2 (dy) të tjerët të kenë titullin “Profesor i Asociuar”.
7. Juria, pasi miratohet nga KGSHD-ja, cakton datën e mbrojtjes publike brenda një afati 15 ditor nga data e miratimit të saj dhe organizon mbrojtjen publike të disertacionit për qëllim vlerësimi.

Neni 33

Oponentët e disertacionit

1. KGSHD-ja cakton 2 (dy) anëtarë të Jurisë si oponentë për vlerësimin shkencor të disertacionit, nga të cilët të paktën njëri duhet të jetë nga një njësi bazë e një institucioni homolog vendas ose i huaj.

2. Nuk mund të emërohen si oponentë persona që kanë qenë të përfshirë në mënyrë substanciale në punën kërkimore të kandidatit të doktoratës. Oponentët kanë për detyrë të:
 - Verifikojnë vërtetësinë dhe integritetin e të dhënave të përdorura në disertacion
 - Vlerësojnë respektimin e praktikave shkencore dhe etike në kryerjen e kërkimit
 - Kontrollon rregullsinë e citimeve dhe referencave bibliografike, si dhe përfshirjen korrekte të burimeve të autorëve të tjerë.
3. Udhëheqësi shkencor i studentit nuk mund të jetë oponent dhe anëtar Jurie.
4. Rekomandohet që të paktën një nga anëtarët e Jurisë së mbrojtjes të jetë nga një universitet i njohur ndërkombëtarisht, me veprimtari të dokumentuar në kërkim dhe publikime shkencore në fushën përkatëse, që zotëron minimalisht gradën “Doktor” dhe ka jo më pak se 5 (pesë) vite përvojë akademike dhe kërkimore.
5. Oponentët paraqesin vlerësimet e tyre me shkrim, të cilat mund të përfshijnë:
 - Rekomandim për dhënien e gradës shkencore “Doktor”
 - Kërkesë për riparaqitje të disertacionit pas përmirësimit në përputhje me rekomandimet e tyre.
 - Shtyrje të afatit të studimeve për përmbushjen e kushteve të kërkuara
 - Refuzim për dhënien e gradës shkencore, kur puna nuk përmbush standardet e kërkuara akademike.

Neni 34

Mbrojtja publike e disertacionit

1. Koha dhe vendi i mbrojtjes publike shpallen të paktën dy javë përpara datës së zhvillimit nga Zëvendësdekani për Shkencën. Mbrojtja është procedurë publike dhe nuk është e vlefshme nëse nuk janë të pranishëm të gjithë anëtarët e jurisë.

Në rast se, për arsye të justifikuara, njëri prej anëtarëve të jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen, përgjegjësi i njësisë bazë njofton drejtuesin e njësisë kryesore, duke propozuar një datë tjetër. Drejtuesi i njësisë kryesore informon Komisionin për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" (KGSHD). Data e re miratohet nga Juria, pas paraqitjes dhe miratimit paraprak nga KGSHD.

E njëjta procedurë zbatohet edhe në rastet kur kandidati për arsye të justifikuara nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar të mbrojtjes.

2. Procedura e mbrojtjes publike drejtohet nga kryetari i jurisë dhe zhvillohet sipas këtyre hapave:
 - a. Hapja e seancës nga kryetari i jurisë, i cili prezanton përbërjen e jurisë, dokumentacionin e kandidatit dhe shpall hapjen zyrtare të mbrojtjes.
 - b. Prezanton kandidati i doktoratës, i cili paraqet objektivat, metodat, rezultatet dhe përfundimet kryesore të kërkimit shkencor, për një kohëzgjatje prej 30–40 minutash.
 - c. Lexohen oponencat, të cilat përmbajnë vlerësimin me shkrim të disertacionit.
 - d. Vijohet me diskutime dhe pyetje nga anëtarët e jurisë dhe të pranishmit në sallë. Të interesuarit nga auditori që duan të komentojnë, duhet të njoftojnë paraprakisht drejtuesin e seancës dhe të respektojnë kohën e kufizuar të ndërhyrjes të përcaktuar nga kryetari i Jurisë.
 - e. Në fund vijohet me sqarime përfundimtare nga kandidati dhe, nëse është e nevojshme, nga udhëheqësi shkencor mbi komentet dhe pyetjet e bëra gjatë seancës.

Neni 35

Vlerësimi i Jurisë mbi Disertacionin

1. Gjatë vlerësimit të disertacionit, Juria duhet të marrë në konsideratë raportet e oponentëve, si dhe të bëjë një vlerësim të përgjithshëm mbi pikat e forta dhe të dobëta të punimit, përfshirë:
 - rëndësinë dhe përputhshmërinë e materialeve dhe metodologjisë së përdorur me objektivat e studimit.
 - forcën logjike të argumenteve dhe vlefshmërinë e përfundimeve të arritura.
2. Udhëheqësi shkencor duhet të jetë i pranishëm gjatë mbrojtjes publike të disertacionit, për të dhënë sqarime lidhur me çështje të natyrës kërkimore, nëse kërkohet nga Juria.
3. Juria mund t'i kërkojë kandidatit që të paraqesë materialet bazë dhe suplementare të përdorura në punimin kërkimor, për të sqaruar elemente të veçanta të disertacionit.
4. Vlerësimi i Jurisë kryhet në mënyrë të fshehtë dhe individuale, përmes sistemit të pikëzimit. Secili anëtar i Jurisë ka në dispozicion 20 pikë, dhe vlerësimi maksimal i mundshëm është 100 pikë.
5. Kriteret e vlerësimit janë si më poshtë:
 - 95–100 pikë: Fiton titullin "*Doktor*" me vlerësimin "Shkëlqyeshëm"
 - 85–94 pikë: Fiton titullin "*Doktor*" me vlerësimin "Shumë mirë"
 - 65–84 pikë: Fiton titullin "*Doktor*" me vlerësimin "Mirë"
 - 50–64 pikë: Fiton titullin "*Doktor*" me vlerësimin "Mjaftueshëm"
 - nën 50 pikë: Nuk fiton titullin "*Doktor*", vlerësimi "Nuk kalon"

6. Rezultati përfundimtar i vlerësimit përmbledhet në procesverbalin zyrtar të mbrojtjes së disertacionit dhe shpallet nga kryetari i Jurisë.
7. Brenda një jave nga data e mbrojtjes publike, Juria përcjell dosjen përfundimtare me raportin e vlerësimit Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".

Neni 36

Marrja e diplomës dhe regjistrimi për gradën shkencore "Doktor"

1. Pas përfundimit të procedurës së mbrojtjes së doktoratës, Juria brenda 1 (një) jave përcjell dosjen e doktoratës me raportin e vlerësimit pranë Drejtuesit të Njesisë Kryesore.
2. Pas plotësimit të dokumentacionit të dosjes, Drejtuesi i njesisë kryesore me shkresë zyrtare brenda 1 (një) jave e përcjell dosjen tek Drejtoria e Shkencës dhe e Promovimit Akademik të UBT-së dhe kërkon regjistrimin e gradës në regjistrin e UBT-së dhe në atë shtetëror të gradave dhe titujve akademikë.
3. Drejtoria e Shkencës dhe e Promovimit Akademik, pasi kontrollon ligjshmërinë e dosjes, i relatton Rektorit të UBT-së mbi procedurën e ndjekur për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe kërkon regjistrimin e saj si në regjistrin e UBT-së edhe në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve akademikë në ministrinë përgjegjëse për arsimin.
4. Pas regjistrimit në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve akademikë, pranë ZSS bëhet regjistrimi i diplomave të doktoratave, sipas njësive kryesore.
5. Përmbajtja e dokumentacionit të dosjes është e mirëpërcaktuar dhe liston një seri dokumentash të organizuara sipas një skede të përgatitur nga Drejtoria e Shkencës dhe Promovimit Akademik të UBT-së, që gjendet në Shtojcën 6 të kësaj rregulloreje.
6. Një kopje e disertacionit të studentit që ka marrë diplomën "Doktor" depozitohet në Bibliotekën e Universitetit Bujqësor dhe një kopje në Bibliotekën Kombëtare.
7. Dosja e plotë e studentit të Doktoratës, së bashku me një kopje të disertacionit dhe autoreferatin, depozitohen në Drejtorinë e Shkencës dhe Promovimit Akademik dhe arkivohen për 5 vjet dhe më pas transferohen në arkivën e UBT-së.
8. Diploma për gradën shkencore "Doktor" nuk lëshohet, pa u depozituar në institucionet e lartpërmendura disertacioni i botuar në hard-copy dhe në disk (CD) dhe pa u bërë publik në faqen zyrtare të UBT-së.
9. Drejtoria e Shkencës dhe Promovimit Akademik e UBT-së përgatit diplomën e gradës shkencore "Doktor", e cila firmoset nga Drejtuesi i njesisë kryesore përkatëse dhe Rektori i UBT-së.
10. Format i diplomës për gradën shkencore "Doktor" përmban të gjithë elementët e parashikuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 37

Mospërfundimi ose ndërprerja e studimeve të doktoratës

1. Në rast se doktoranti nuk arrin të përfundojë ose ndërpret përgatitjen e disertacionit brenda afatit të caktuar, ai mund të pajiset me një vërtetim për rezultatet e arritura. Vërtetimi lëshohet nga drejtuesi i njësisë kryesore, pas konceptimit nga drejtuesi i njësisë bazë në lidhje me arritjet e studentit të doktoratës. Drejtuesi i njësisë kryesore vë në dijeni Komisionin për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.

Neni 38

Transferimi i studimeve në programin e doktoratës

1. Kandidalet që ndjekin një program studimi të doktoratës në institucione të arsimit të lartë, vendas ose të huaj, lejohet të transferojnë këto studime, kur fushat e studimit janë të njëjta ose të përafërta me programin e “Doktoratës”, të njësisë kryesore.
2. Me qëllim lejitimit të transferimit të doktoratës, nga një IAL tjetër vendase ose e huaj, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, njësia kryesore ringre një komision ad hoc, me tre anëtarë, për të verifikuar nivelin e ngjashmërisë së programeve të doktoratave, fazën dhe nivelin e punimit të doktorantit. Vendimi përfundimtar merret nga drejtuesi i njësisë kryesore, pas propozimit të komisionit ad hoc, i cili jo domosdoshmërisht, mund të jetë pjesë e njësisë bazë.
3. Kur transferimi kërkohet nga një kandidat i një institucioni tjetër të arsimit të lartë, për në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe programi i doktoratës kryhet me vetëfinancim, transferimi kryhet duke mbajtur parasysh kriteret e parashikuara nga kjo Rregullore, për pranimin në një program studimi të doktoratës.
4. Kur transferimi kërkohet nga një kandidat në program studimi të doktoratës nga Universiteti Bujqësor i Tiranës në një institucion tjetër të arsimit të lartë dhe programi i doktoratës kryhet me vetëfinancim, transferimi kryhet duke mbajtur parasysh kriteret e parashikuara nga kjo Rregullore për pranimin në një program studimi të doktoratës.
5. Kur burimi i financimit është i ndryshëm nga ai i përcaktuar në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, transferimi mund të kryhet në varësi të burimit të financimit.
6. Verifikimi i mundësisë së transferimit të programit të studimeve të doktoratës, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga një komision ad hoc i ngritur pranë njësisë kryesore, që ka organizuar këtë program studimi. Vendimi përfundimtar nxirret nga Rektori, pas propozimit të drejtuesit të njësisë kryesore.
7. Në rast financimi nga UBT, për kërkimin shkencor mbi projektin e doktoratës përkatëse, kandidati që kërkon transferimin në një tjetër IAL, vendase ose të huaj, së bashku me kërkesën e tij për transferim, do të kompensojë UBT-në për financimin e bërë.
8. Në çdo rast transferimi, kandidati duhet të ketë konfirmim zyrtar nga institucioni ku do të transferohet se, ky i fundit ka kapacitete të lira për udhëheqjen e kandidatit që kërkon të transferoj studimet”.

Neni 39

Anulimi i gradës shkencore "Doktor"

1. Grada shkencore "Doktor" mund të anulohet në rastet kur vërtetohet se, në veprimtarinë shkencore, që ka shërbyer për fitimin e gradës shkencore, konstatohen sjellje dhe praktika të papranueshme, në kundërshtim me parimet e etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor, konkretisht.
 - a) Fabrikim — sajim i rezultateve dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta,
 - b) Falsifikim - manipulim i materialeve të kërkimit, pajisjeve apo proceseve ose ndryshinti, heqja apo shmangia e të dhënave apo rezultateve pa justifikim,
 - c) Plagjiature - përdorim i ideve dhe punes së të tjerëve pa ia njohur vlerën burimit origjinal, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.
2. Grada shkencore "Doktor", mund të anulohet edhe kur vërtetohet se, kandidati ka paraqitur të dhëna të pavërteta, ose i ka falsifikuar ato, me qëllim përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave, për fitimin e saj.
3. Vendimi për shfuqizimin, merret vetëm pasi të jenë ndjekur procedurat administrative, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative.
4. Barra e provës për të provuar akuzat mbi plagjiaturën ose manipulimin e të dhënave në punimet e kandidatit, bie mbi subjektin që ka ngritur akuzën.
5. Vendimi merret me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Gradës Shkencore "Doktor" të njësisë kryesore përkatëse, pas rekomandimit të dhënë nga komisioni ad hoc, i caktuar nga ky Komision, i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë të personelit akademik të njësisë kryesore, të kategorisë "Profesor", të së njëjtës fushë ose fushave të përafërta.
6. Përpara marrjes së vendimit, komisioni ad hoc njofton personin ndaj të cilit ka filluar procedimi.
 - a) për akuzat e ngritura sipas pikës 1 dhe/ose 2 të këtij neni,
 - b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth akuzës së ngritur, si dhe një afat të arsyeshëm, deri kur duhet të paraqitet ky sqarim,
 - c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t'u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre;
7. Pasi komisionit ad hoc t'i jete vene ne dispozicion informacioni i kërkuar sipas gërmes b)

të pikës 6, të kësaj dispozite, ky i fundit njofton personin ndaj të cilit ka filluar procedimi, për datën kur do të shqyrtohet akuza e pretenduar, e cila nuk mund të caktohet më shpejt se 5 (pese) dite pune dhe jo më vonë se 10 (dhjete) dite pune, nga marrja e njoftimit.

8. Procesi i verifikimit kryhet në mënyrë të paanshme, gjithëpërfshirëse, pa cenuar saktësinë dhe objektivitetin e procedimit.
9. Palet e përfshira në procedimin administrativ, deklarojnë çdo konflikt interesi që mund të dalë gjatë verifikimit. Procedurat kryhen në mënyrë konfidenciale, me qëllim mbrojtjen e personave, që janë të përfshirë në verifikim.”.

Neni 40

Administrimi dhe financimi

1. Njësia që organizon programin e studimeve të ciklit të tretë duhet të ketë në dispozicion asete dhe mjedise administrative të mjaftueshme për të realizuar mirëfunksionimin e programit të studimeve të doktoratës.
2. Organet përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programit të studimeve të doktoratës janë: KGSHD-të e njësive kryesore, Zëvendësdekani i programit të studimeve të doktoratës, njësia bazë, njësia kryesore ku është atashuar studenti i doktoratës dhe udhëheqësi i doktorantit.
3. Shpenzimet për kryerjen e doktoratës planifikohen dhe mbulohen nga projekte të ndryshme kërkimore të mbështetura nga ministria, nga projektet kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare të përfuara nga udhëheqësit shkencorë të doktorantëve për këtë program studimesh, nga tarifa e regjistrimit dhe e shkollimit të kandidatit, nga shërbime për të tretë që realizojnë njësitë bazë, si dhe nga sponsorizime ose burime të tjera publike e private, apo edhe me vetëfinancim nga doktorantët.
4. Kandidati paguan një tarifë aplikimi, tarifë regjistrimi dhe tarifën për ciklin e tretë të studimeve, të cilat përcaktohen me vendim të Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.

Neni 41

Dispozita kalimtare

1. Kjo rregullore zbatohet për studentët që do të regjistrohen në programet e studimit të doktoratës pas hyrjes në fuqi të saj. Për studentët që kanë filluar programin para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 80/2-15 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij.

2. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje: njësitë bazë, njësitë kryesore të UBT-së, zëvendësdekanët për shkencën, KGSHD e UBT-së, përgjegjësit e programeve të studimeve të ciklit të tretë, komisionet e gradave shkencore të njësive kryesore dhe Drejtoria e Shkencës dhe Promovimit Akademik në UBT.
3. Njësitë hartojnë rregullore të brendshme, duke evidentuar specifikat në procedura dhe kërkim, por pa rënë ndesh me përkufizimet e kësaj rregulloreje, e cila duhet të konsiderohet “Rregullore Bazë” dhe të njihet e zbatohet nga të gjitha njësitë kryesore të UBT-së.
4. Të drejtën për amendime në këtë rregullore e ka vetëm Senati Akademik, me propozimet përkatëse të Dekanateve të njësive kryesore të UBT-së, Komisioneve të Gradave Shkencore dhe Drejtorisë së Shkencës dhe Promovimit Akademik, në përputhje me aktet rregullatore të UBT-së.

Neni 42

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore, hyn në fuqi pas miratimit nga Senati i UBT-së.

